



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Më datën 13.03.2014 Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të paparalajmëruar në Stacionin Policor për kontroll kufitare-Dellçevë, ndërsa vizita u realizua në bashkëpunim me bashkëpunëtorë të jashtëm të Shoqatës Maqedonase të juristëve të ri e cila është regjistruar si shoqatë për dhënien falas të ndihmës juridike dhe është inkuadruar për dhënien e ndihmës juridike azilantëve në Qendrën për pranim të azilkërkuesve.

Qëllimi i vizitës është përcaktuar konform Protokollit Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese, ka për qëllim identifikimin e rreziqeve me qëllim të parandalimit të torturës ose llojit tjetër të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues. Vizita në Stacionit policor për kontroll kufitare-Dellçevë u realizua në mënyrë që fillimisht u realizua biseda me kryeshefin e SP, ndërsa mëpas ekipi i MPN-së, bëri inspektim në ambientet e stacionit policor, si dhe inspektim në evidencën e personave të privuar nga liria.

SP për kontroll kufitare-Dellçevë nuk është përcaktuar konform Aktvendimit për stacion policor për ndalimin e personave të privuar nga liria, prandaj në stacionin e njëjtë nuk ka ambient të veçantë të dedikuar për këtë qëllim. Megjithatë, duke marrë parasysh kompetencat që ka i njëjti stacion mund të privojë nga liria persona të cilët kërkohen, përkatësisht për të cilët është lëshuar fletarrest ose bëhet fjalë për persona të cilët në mënyrë ilegale kanë hyrë në shtet.

Konform informatave të pranuar nga kryeshefi, ky stacion nuk ka ambient të veçantë për ndalim të përkohshëm të personave të privuar nga liria. Ndalimi i përkohshëm bëhet në ambientin e udhëheqësit të ndërresës, mirëpo në raste kur ka më shumë persona të arrestuar ndalimi i përkohshëm bëhet në sallën e stacionit policor në prani të zyrtarëve policor. Ekipi i MPN-së konsideron se salla e cila shfrytëzohet për ndalim afatshkurtë të personave të privuar nga liria nuk është përkatëse për qëllime të tilla, madje as për ato ndalime të cilat zgjasin disa orë, sepse personat e ndalur përkohësisht u nënshtrohen shikimeve dhe kureshtjes së qytetarëve të tjerë të cilët në moment të caktuar janë gjetur në ambientet zyrtare të stacionit Policor për kontroll kufitare-Dellçevë.

Vendkalimi kufitar-Dellçevë nuk disponon me ambient të veçantë për bastisje/kontroll të personave të privuar nga liria, as me ambient të veçantë për azilkërkues.

Ekipi i MPN-së bëri inspektim në disa ambiente të objektit të stacionit policor me ç'rast u konstatua se të drejtat e personave të privuar nga liria dhe kodi i etikës policore janë shfaqur në vende të dukshme që të kenë qasje qytetarët, më saktë, në vet hyrjen e sallës së stacionit policor për kontroll kufitare. Megjithatë, në zyrën e udhëheqësit të ndërresës nuk ishin vendosur posterë me të drejtat e personave të cilët janë privuar nga liria, prandaj MPN-ja konsideron se të drejtat e personave të privuar nga liria duhet të shfaqen edhe në ambientet e udhëheqësit të ndërresës

(deri te shërbimi kujdestar), sepse ky është ambienti i parë në të cilin personat vijnë në kontakt me personat zyrtar dhe ku njoftohen me të drejtat e tyre.

Mekanizmi Parandalues Nacional gjatë vizitës së SP për kontroll kufitare-Dellçevë realizoi inspektim në tërë evidencën e cila ka të bëjë me personat e privuar nga liria, më saktë, u bë inspektim në Librin për persona të privuar nga liria dhe ndalim, në Librin për ngjarje ditore, Librin për përdorim të mjeteve për detyrim, gjithashtu u kontrolluan 4 dosje individuale për persona të privuar nga liria sipas zgjedhjes së rastësishme. Në bazë të inspektimit në Librin për persona të privuar nga liria dhe ndalim, u konstatua se ky regjistër udhëhiqet në mënyrë të drejtë, në tërësi janë plotësuar të gjitha fushat e formularëve, Libri për ngjarje ditore udhëhiqet në mënyrë të shpejtë, mirëpo, në disa vende për të dhënat e evidentuara në mënyrë të gabueshme, shfrytëzohet korrektori. Në stacionin policor është evidente lidhshmëria numerike e Librit për ngjarje ditore me Librin për persona të privuar nga liria.

Nga inspektimi në procesverbalin për ndalim dhe procesverbalin për këshilla, u vërejt se personat të cilët janë arrestuar çdoherë janë njoftuar për të drejtat e tyre, të thërrasin mbrojtës dhe t'u bëhet kontroll mjeksore nëse u nevojitet.

Mekanizmi parandalues nacional hartoi raport të veçantë për vizitën e realizuar në të cilin u konstatuan gjendjet pozitive dhe negative dhe u dhanë rekomandime përkatëse për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe për kryeshefin e SP-KK-Dellçevë.